
RREGULLORE (BE) NR. 515/2014 E PARLAMENTIT EVROPIAN DHE E KËSHILLIT, DATË 16 PRILL 2014, "PËR KRIJIMIN, SI PJESË E FONDIT TË SIGURISË SË BRENDSHME, E INSTRUMENTIT PËR MBËSHTETJEN FINANCIARE PËR KUFIJTË E JASHTËM DHE VIZAT" DHE QË SHFUQIZON VENDIMIN NR. 574/2007/KE

PARLAMENTI EVROPIAN DHE KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin për Funksonimin e Bashkimit Evropian dhe në veçanti nenin 77, paragrafi 2 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Komisionit Evropian,

Pas komunikimit të projektaktit legjislativ në parlamentet kombëtare,

Duke pasur parasysh opinionin e Komitetit Evropian Ekonomik dhe Social¹,

Duke pasur parasysh opinionin e Komitetit të Rajoneve²,

Duke vepruar në përputhje me procedurën e zakonshme legjislative³,

Meqë:

1. Objektivi i BE-së për të siguruar një nivel të lartë sigurie në një zonë lirie, sigurie dhe drejtësie sipas nenit 67, paragrafi 3 të Traktatit për Funksonimin e BE-së (TFBE) duhet të arrihet, ndër të tjera, nëpërmjet masave të përbashkëta për kalimin e kufijve të brendshëm nga njerëzit dhe kontrollin kufitar në kufijtë e jashtëm dhe politikën e përbashkët të vizave si pjesë e një sistemi konvergjent shumështrësor, i cili do të lejonte shkëmbimin e të dhënave dhe një ndërgjegjësim të plotë ndaj situatës dhe i cili ka për qëllim të lehtësojë udhëtimin e ligjshëm dhe të gjurmojë emigracionin e paligjshëm.

2. BE-ja ka nevojë për një qasje më koherente ndaj aspekteve të brendshme dhe të jashtme të menaxhimit të migracionit dhe sigurisë së brendshme dhe duhet të krijojë një lidhje midis luftës kundër emigracionit të paligjshëm dhe përmirësimit të sigurisë së kufijve të jashtëm të BE-së dhe bashkëpunim më të mirë dhe dialog me vende të treta me qëllim që të trajtohet emigracioni i paligjshëm dhe të promovohet ai i ligjshëm.

3. Është e domosdoshme që të zhvillohet një qasje e integruar për problemet që lindin nga presioni i migracionit dhe aplikimeve për azil dhe për menaxhimin e kufijve të jashtëm të BE-së dhe për të siguruar buxhetin dhe burimet e përshtatshme për t'u përballur me emergjencat në frymën e respektimit të të drejtave të njeriut dhe solidaritetit ndërmjet të gjitha shteteve anëtare, ndërkohë që mbeten të vetëdijshëm për përgjegjësitë kombëtare dhe sigurojnë një ndarje të qartë të detyrave.

4. Strategjia për Sigurinë e Brendshme e Bashkimit Evropian ("Strategjia për Sigurinë e Brendshme"), e miratuar nga Këshilli në shkurt të 2010, përbën një axhendë të përbashkët për trajtimin e këtyre sfidave të përbashkëta të sigurisë. Komunikata e Komisionit e nëntorit 2010, me titull "Strategjia e BE-së për Sigurinë e Brendshme në Veprim" përktheu parimet dhe udhëzimet e strategjisë në masa konkrete duke identifikuar pesë objektiva strategjike: prishja e rrjeteve kriminale ndërkombëtare, parandalimi i terrorizmit dhe gjetja e një zgjidhjeje për radikalizimin dhe rekrutimin, rritja e nivelit të sigurisë për qytetarët dhe bizneset në hapësirën kibernetike, forcimi i sigurisë nëpërmjet menaxhimit të kufijve dhe rritja e qëndrueshmërisë së Evropës përballë krizave dhe fatkeqësive.

5. Sipas Strategjisë së Sigurisë së Brendshme, liria, siguria dhe drejtësia janë objektiva që duhen ndjekur paralelisht dhe për të arritur lirinë dhe drejtësinë, siguria gjithmonë duhet të ndiqet në përputhje me parimet e traktateve, shtetin e së drejtës dhe detyrimet e BE-së ndaj të drejtave themelore.

6. Solidariteti midis shteteve anëtare, ndarja e qartë e detyrave, respektimi i lirive dhe të drejtave themelore të njeriut dhe shteti i së drejtës, përqendrimi i fortë në perspektivën globale dhe lidhja me sigurinë e jashtme, dhe qëndrueshmëria e koherenca me objektivat e politikës së jashtme të BE-së, siç përcaktohet në nenin 21 të Traktatit për Bashkimin Evropian (TBE), duhet të jenë parimet kryesore që udhëheqin zbatimin e Strategjisë për Sigurinë e Brendshme.

7. Për të nxitur zbatimin e Strategjisë për Sigurinë e Brendshme dhe për të siguruar që ajo të bëhet një realitet operacional, shteteve anëtare duhet t'u jepet mbështetja e duhur financiare nga BE, duke krijuar një Fond të Sigurisë së Brendshme ("Fondi").

8. Për shkak të veçorive ligjore të zbatueshme për titullin V të TFBE-së, krijimi i Fondit si një instrument financiar i vetëm është juridikisht i pamundur. Fondi duhet të krijohet si një kuadër gjithëpërfshirës për mbështetjen financiare nga BE në fushën e sigurisë së brendshme, që përfshin instrumentin për mbështetje financiare për kufijtë e jashtëm dhe vizat ("Instrumenti") të përcaktuar me këtë rregullore si dhe instrumentin për mbështetje financiare për bashkëpunimin policor, parandalimin dhe luftën ndaj krimit dhe menaxhimit të krizave, i krijuar nga Rregullorja (BE) nr. 513/2014 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit⁴. Ky kuadër gjithëpërfshirës duhet të plotësohet nga Rregullorja (BE) nr. 514/2014 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit⁵ të cilës duhet t'i referohet kjo Rregullore në lidhje me rregullat për programimin, menaxhimin financiar, menaxhimin dhe kontrollin, likuidimin e llogarive, mbylljen e programeve dhe raportimin dhe vlerësimin.

9. Struktura e re me dy shtylla e financimit në fushën e punëve të brendshme duhet të kontribuojë në thjeshtësimin, racionalizimin, konsolidimin dhe transparencën e financimit në këtë fushë. Duhet të kërkohen sinergji, qëndrueshmëri dhe plotësim me fonde dhe programe të tjera, duke përfshirë edhe synimin për shpërndarjen e fondeve për objektivat e përbashkëta. Megjithatë, duhet shmangur mbivendosja midis instrumenteve të ndryshëm financues.

10. Fondi duhet të pasqyrojë nevojën për rritjen e fleksibilitetit dhe thjeshtësimit, duke respektuar kërkesat e parashikueshmërisë dhe duke siguruar një shpërndarje të drejtë dhe transparente të burimeve për të përmbushur objektivat e përgjithshme dhe specifike të përcaktuara në këtë rregullore.

11. Efikasiteti i masave dhe cilësia e shpenzimeve përbëjnë parime udhëzuese në zbatimin e Fondit. Për më tepër, Fondi duhet të zbatohet në mënyrën më efektive dhe më miqësore të mundshme ndaj përdoruesit.

12. Fondi duhet të marrë parasysh veçanërisht ato shtete anëtare që përballen me ngarkesa joproporcionale nga flukset e emigracionit për shkak të vendndodhjes së tyre gjeografike.

13. Solidariteti dhe ndarja e përgjegjësisë midis shteteve anëtare dhe BE-së është një element thelbësor i politikës së përbashkët për menaxhimin e kufijve të jashtëm.

14. Fondi duhet të shprehë solidaritet nëpërmjet ndihmës financiare për ato shtete anëtare që zbatojnë plotësisht dispozitat e Shengenit për kufijtë e jashtëm si dhe për ato që po përgatiten për pjesëmarrje të plotë në Shengen dhe duhet të përdoret nga shtetet anëtare në interes të politikës së përbashkët të BE-së për menaxhimin e kufijve të jashtëm.

15. Për të kontribuar në arritjen e objektivit të përgjithshëm të Fondit, shtetet anëtare duhet të sigurojnë që programet e tyre kombëtare të trajtojnë objektivat specifike të Instrumentit dhe se alokimi i burimeve sipas objektivave është proporcional me sfidat dhe nevojat dhe siguron që objektivat mund të arrihen. Kur një program kombëtar nuk trajton një nga objektivat specifike ose alokimi është nën përqindjet minimale për disa objektiva të programeve kombëtare të përcaktuara në këtë rregullore, shteti anëtar në fjalë duhet të japë një justifikim brenda programit.

16. Për të matur arritjet e Fondit, duhet të përcaktohen tregues të përbashkët në lidhje me çdo objektiv specifik të Instrumentit. Matja e arritjes së objektivave specifikë përmes treguesve të përbashkët nuk e bën të detyrueshëm zbatimin e masave që lidhen me këta tregues.

17. Pjesëmarrja nga një shtet anëtar nuk duhet të përkojë me pjesëmarrjen e tij në një instrument të përkohshëm financiar të BE-së, i cili mbështet shtetin anëtar përfitues për të financuar, ndër të tjera, masat në kufijtë e rinj të jashtëm të BE-së për zbatimin e tërësisë së legjislacionit të Shengenit për kufijtë dhe vizat dhe kontrollin e kufijve të jashtëm.

18. Instrumenti duhet bazohet në procesin e ngritjes së kapaciteteve që është zhvilluar me ndihmën e Fondit për Kufijtë e Jashtëm për periudhën 2007-2013, krijuar nga Vendimi nr. 574/2007/KE i Parlamentit Evropian dhe i Këshillit⁶, dhe duhet ta zgjerojë atë për të marrë parasysh zhvillimet e reja.

19. Gjatë kryerjes së detyrave në kufijtë e jashtëm dhe konsullatat në përputhje me tërësinë e legjislacionit të Shengenit për kufijtë dhe vizat, shtetet anëtare kryejnë veprimtari në interes të dhe në emër të të gjitha shteteve të tjera anëtare në zonën Shengen, duke kryer kështu një shërbim publik për BE-në. Instrumenti duhet të kontribuojë në mbështetjen e shpenzimeve operative në lidhje me politikat e kontrollit të kufijve dhe politikat e vizave dhe t'u mundësojë vendeve anëtare të ruajnë aftësitë që janë vendimtare për të gjithë në lidhje me atë shërbim. Kjo mbështetje konsiston në rimbursimin e plotë të kostove specifike, sipas zgjedhjes, në lidhje me objektivat e Instrumentit dhe duhet të jetë pjesë përbërëse e programeve kombëtare.

20. Instrumenti duhet të plotësojë dhe të përforcojë aktivitetet e ndërmarra për të zhvilluar bashkëpunimin operacional nën kujdesin e Agjencisë Evropiane për Menaxhimin e

Bashkëpunimit Operacional në Kufijtë e Jashtëm të Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian ("Agjencia Frontex") themeluar nëpërmjet Rregullores së Këshillit (KE) nr. 2007/2004⁷, përfshirë aktivitetet e reja që lindin nga ndryshimet e futura nga Rregullorja (BE) nr. 1168/2011 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit⁸, dhe duke forcuar kështu më tej solidaritetin midis atyre shteteve anëtare që kontrollojnë kufijtë e jashtëm në interesin e dhe në emër të zonës Shengen si një e tërë. Kjo, ndër të tjera, nënkupton që, kur hartohen planet e tyre kombëtare, shtetet anëtare duhet të mbajnë parasysh mjetet analitike dhe operacionale si dhe udhëzimet teknike të zhvilluara nga Agjencia Frontex si dhe nga kurrikula për trajnimin, përkatësisht kurrikula bazë e përbashkët për rojet kufitare, përfshirë përbërësit e saj në lidhje me të drejtat themelore dhe aksesin në mbrojtje ndërkombëtare. Për të zhvilluar komplementaritetin mes misionit të tij dhe përgjegjësisë të shteteve anëtare për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufijve të jashtëm, si dhe për të siguruar qëndrueshmëri dhe për të shmangur joefikasitetin e kostos, Komisioni duhet të konsultohet me Agjencinë Frontex mbi projekt-programet kombëtare të paraqitura nga shtetet anëtare dhe në veçanti për aktivitetet e financuara nga mbështetja operative.

21. Instrumenti duhet të zbatohet në përputhje të plotë me të drejtat dhe parimet e përcaktuara në Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian dhe me detyrimet ndërkombëtare të BE-së dhe pa cenuar zbatimin e dispozitave të veçanta lidhur me të drejtën për azil dhe mbrojtjen ndërkombëtare.

22. Kontrolli i njëtrajtshëm dhe cilësor i kufijve të jashtëm është thelbësor për forcimin e fushës së lirisë, sigurisë dhe drejtësisë. Në përputhje me standardet e përbashkëta të BE-së, Instrumenti duhet të mbështesë masat që kanë të bëjnë me menaxhimin e kufijve të jashtëm, që do të zbatohen në përputhje me modelin e kontrollit të qasjes me katër nivele që përfshin masat në vendet e treta, bashkëpunimin me vendet fqinje, masat e kontrollit kufitar dhe masat e kontrollit brenda zonës së lëvizjes së lirë, me qëllim parandalimin e emigracionit të paligjshëm dhe krimit ndërkufitar brenda zonës Shengen.

23. Në përputhje me nenin 3 të TBE-së, Instrumenti duhet të mbështesë aktivitetet që sigurojnë mbrojtjen e fëmijëve në rrezik lëndimi në kufijtë e jashtëm. Në veçanti, kur zbatohen masat në lidhje me identifikimin, ndihmën e menjëhershme dhe referimin te shërbimet mbrojtëse, shtetet anëtare duhet që kurdoherë t'u kushtojnë vëmendje të veçantë personave në nevojë, veçanërisht fëmijëve dhe të miturve të pashoqëruar.

24. Për të siguruar një kontroll të njëtrajtshëm dhe me cilësi të lartë të kufirit të jashtëm dhe për të lehtësuar udhëtimin e ligjshëm nëpër kufijtë e jashtëm brenda kuadrin të Strategjisë për Sigurinë e Brendshme, Instrumenti duhet të kontribuojë në zhvillimin e një sistemi të përbashkët evropian të menaxhimit të integruar të kufijve. Sistemi përfshin të gjithë masat që kanë të bëjnë me politikën, legjislacionin, bashkëpunimin sistematik, ndarjen e përgjegjësisë, vlerësimin e situatës dhe ndryshimin e rrethanave për sa u përket pikave të kalimit kufitar për emigrantët e parregullt, personelin, pajisjet dhe teknologjinë, të marra në nivele të ndryshme nga autoritetet kompetente të shteteve anëtare, që veprojnë në bashkëpunim me Agjencinë Frontex, me vende të treta dhe, sipas rastit, me aktorë të tjerë, në veçanti Europolin dhe Agjencinë për Menaxhimin Operacional të Sistemeve IT në shkallë të gjerë, duke përdorur, ndër të tjera, modelin e kontrollit të kufijve me katër nivele dhe analizën e integruar të rrezikut e BE-së.

25. Në përputhje me Protokollin nr. 5 për Aktin e Anëtarësimit të vitit 2003 "Për transitin në rrugë tokësore të personave midis rajonit të Kaliningradit dhe pjesëve të tjera të Federatës Ruse, Instrumenti duhet të mbulojë çdo kosto shtesë të kryer gjatë zbatimit të dispozitave specifike të tërësisë së legjislacionit të BE-së që mbulojnë këtë transit", d.m.th. Rregullorja e Këshillit (KE) nr. 693/2003⁹ dhe Rregullorja e Këshillit (KE) nr. 694/2003¹⁰. Megjithatë, nevoja për mbështetje financiare të vazhdueshme për pagesat e paregjistruara duhet të varet nga regjimi i vizave që BE ka vendosur për Federatën Ruse.

26. Instrumenti duhet të përfshijë mbështetjen për masat kombëtare dhe bashkëpunimin midis shteteve anëtare në fushën e politikës së vizave dhe veprimtarive të tjera para-kufitare që kryhen para kontrolleve në kufirin e jashtëm dhe duhet të shfrytëzojnë plotësisht Sistemin e Informacionit të Vizave (SIV). Menaxhimi efikas i aktiviteteve të organizuara nga shërbimet e shteteve anëtare në vendet e treta është në interes të politikës së përbashkët të vizave si pjesë e një sistemi me shumë shtresa që synon lehtësimin e udhëtimit të ligjshëm dhe luftën kundër emigracionit të paligjshëm në Bashkimin Evropian dhe përbën një pjesë integrale të sistemit të përbashkët të menaxhimit të integruar të kufijve.

27. Për më tepër, Instrumenti duhet të mbështesë masat në territorin e vendeve të Shengenit si pjesë e zhvillimit të një sistemi të përbashkët të integruar të menaxhimit të kufijve, i cili forcon funksionimin e përgjithshëm të zonës Shengen.

28. Instrumenti duhet gjithashtu të mbështesë zhvillimin e sistemeve të IT-së të BE-së, bazuar në sistemet ekzistuese dhe/ose të reja të IT-së, të cilat do t'i pajisnin shtetet anëtare me mjetet për të menaxhuar me efikasitet lëvizjen e shtetasve të vendeve të treta përtej kufijve dhe për të siguruar identifikimin dhe verifikimin e udhëtarëve, duke lehtësuar kështu udhëtimin dhe rritjen e sigurisë së kufirit. Për këtë qëllim, duhet të krijohet një program, në përputhje me Strategjinë e Menaxhimit të Informacionit për sigurinë e brendshme të BE-së me qëllim mbulimin e kostove për zhvillimin e përbërësve qendrorë dhe kombëtarë të sistemeve të tilla, duke siguruar përputhshmëri teknike, ndërveprueshmëri me sistemet e tjera të IT-së në BE, kosto më të ulëta dhe një zbatim pa probleme në shtetet anëtare. Ato sisteme të IT-së duhet të jenë në pajtim me të drejtat themelore, përfshirë mbrojtjen e të dhënave personale.

29. Shtetet anëtare duhet t'i dedikojnë fondet e duhura Sistemit Evropian për Mbikëqyrjen e Kufijve (Eurosur), i ngritur nëpërmjet Rregullores (BE) nr. 1052/2013 së Parlamentit Evropian dhe Këshillit¹¹, për të garantuar mbarëvajtjen e atij sistemi.

30. Për t'iu përgjigjur presionit të paparashikuar migrator dhe rreziqeve për sigurinë kufitare, duhet të krijohet mundësia për të ofruar asistencë emergjente në përputhje me kuadrin e përcaktuar në Rregulloren (BE) nr. 514/2014.

31. Për më tepër, në interes të rritjes së solidaritetit në zonën Shengen në tërësi, kur identifikohen dobësitë ose rreziqet e mundshme, veçanërisht pas një vlerësimi të Shengenit, shteti anëtar në fjalë duhet të ndjekë çështjen në mënyrë të përshtatshme duke përdorur burimet në kuadër të programit të tij kombëtar sipas prioriteteve, sipas rastit, duke plotësuar masat e ndihmës emergjente.

32. Për të përforcuar solidaritetin dhe ndarjen e përgjegjësive, shtetet anëtare duhet të inkurajohen të përdorin një pjesë të burimeve të disponueshme në kuadër të programeve të tyre kombëtare për prioritetet specifike të përcaktuara nga BE, të tilla si blerja e pajisjeve teknike të nevojshme për Agjencinë Frontex dhe zhvillimi i bashkëpunimit konsullor për BE-në. Ekziston nevoja për të maksimizuar ndikimin e financimit të BE-së duke mobilizuar, bashkuar dhe shfrytëzuar burimet financiare publike dhe private. Duhet të garantohet transparenca maksimale, llogaridhënia dhe shqyrtimi i imtësishëm demokratik për instrumentet financiare novatore dhe mekanizmat që përfshijnë buxhetin e BE-së.

33. Për të mbrojtur zbatimin e tërësisë së legjislacionit të Shengenit në të gjithë zonën e tij, zbatimi i Rregullores së Këshillit (BE) nr. 1053/2013¹² duhet të mbështetet gjithashtu në kuadër të Instrumentit, si një mjet thelbësor për lehtësimin e zbatimit të politikave të BE-së në zonën e lirisë, drejtësisë dhe sigurisë duke garantuar një nivel të lartë të mbrojtjes së kufijve të jashtëm dhe mungesën e kontrolleve kufitare brenda zonës Shengen.

34. Në kuadër të përvojës së fituar me Fondin e Kufijve të Jashtëm dhe zhvillimin e SIS II dhe VIS, gjykohet me vend lejimi i një farë fleksibiliteti në lidhje me transferimet e mundshme të burimeve ndërmjet mjeteve të ndryshme të zbatimit të objektivave të ndjekura në kuadër të Instrumentit, pa cenuar parimin e garantimit që në fillim të një mase kritike dhe stabilitetit financiar për programet dhe mbështetjes operative për shtetet anëtare dhe pa cenuar shqyrtimin e imtësishëm nga Parlamenti Evropian dhe Këshilli.

35. Në të njëjtën mënyrë, fusha e zbatimit të masave dhe tavani për burimet që mbeten në dispozicion të BE-së ("Veprimet e BE-së") duhet të rriten për të rritur kapacitetin e BE-së për të kryer, në një vit të caktuar buxhetor, aktivitete të shumta për menaxhimin e kufijve të jashtëm dhe politikat e përbashkëta të vizave në interes të BE-së në tërësi, kur dhe për aq sa lind nevoja. Masa të tilla të BE-së përfshijnë studime dhe projekte pilot për të menaxhuar më tej kufijtë e jashtëm dhe politikën e përbashkët të vizave dhe zbatimin e tyre, trajnimin e rojeve kufitare në mbrojtjen e të drejtave të njeriut, masa në vendet e treta që iu përgjigjen presioneve migratore nga ato vende, në interesat e një menaxhimi optimal të flukseve të emigracionit drejt BE-së dhe të një organizimi efikas të detyrave përkatëse në kufijtë e jashtëm dhe konsullata.

36. Masat në dhe në lidhje me vendet e treta të mbështetura përmes Instrumentit duhet të merren në sinergji dhe në koherencë me masa të tjera jashtë BE-së të mbështetura nëpërmjet instrumenteve të ndihmës së jashtme të BE-së, si gjeografike ashtu edhe tematike. Në veçanti, në zbatimin e veprimeve të tilla, duhet të kërkohet koherenca e plotë me parimet dhe objektivat e përgjithshme të veprimit të jashtëm të BE-së dhe të politikës së saj të jashtme në lidhje me vendin ose rajonin në fjalë. Ato nuk duhet të synojnë të mbështesin masat që orientohen drejtpërdrejtë drejt zhvillimit dhe duhet të plotësojnë, sipas rastit, ndihmën financiare të ofruar nëpërmjet instrumenteve të ndihmës së jashtme. Sa i përket zbatimit të masave emergjente në veçanti, do të kërkohet koherencë me politikën humanitare të BE-së.

37. Financimi nga buxheti i BE-së duhet të përqendrohet në aktivitetet ku ndërhyrja e BE-së mund të sjellë vlerë të shtuar krahasuar me masat nga shtetet anëtare më vete. Duke qenë se BE-ja është në një pozicion më të mirë sesa shtetet anëtare për të siguruar një kuadër për të shprehur solidaritetin e saj në kontrollin e kufirit, politikën e vizave dhe menaxhimin e flukseve të emigracionit dhe për të ofruar një platformë për zhvillimin e sistemeve të përbashkëta të IT-së

që mbështesin këto politika, mbështetja financiare e parashikuar në këtë rregullore do të kontribuojë në veçanti për forcimin e aftësive kombëtare dhe të BE-së në këto fusha.

38. Kjo rregullore duhet të përcaktojë alokimin e shumave bazë për shtetet anëtare. Shuma bazë për secilin shtet anëtar duhet të llogaritet në bazë të alokimeve të Fondit për Kufijtë e Jashtëm për çdo shtet anëtar në vitet 2010-2012 dhe duke pjesëtuar shifrën e përfutur me totalin e ndarjeve buxhetore të disponueshme për menaxhimin e përbashkët për këto tre vite. Llogaritjet janë bërë në përputhje me kriteret e shpërndarjes të përcaktuara në Vendimin nr. 574/2007/KE.

39. Komisioni duhet të monitorojë zbatimin e Instrumentit, në përputhje me dispozitat përkatëse të Rregullores (BE) nr. 514/2014, me ndihmën e treguesve kryesorë për vlerësimin e rezultateve dhe të ndikimeve. Duke përfshirë referencat përkatëse bazë, treguesit duhet të sigurojnë bazën minimale për vlerësimin e shkallës së arritjes së objektivave të Instrumentit.

40. Për të plotësuar ose ndryshuar dispozita të kësaj rregulloreje që lidhen me përkufizimin e masave të caktuara nën programet kombëtare, kompetencat për miratimin e akteve në përputhje me nenin 290 të TFBE-së duhet t'i delegohen Komisionit. Është shumë e rëndësishme që gjatë punës së tij përgatitore Komisioni të kryejë konsultimet e duhura, duke përfshirë ato në nivel ekspertësh. Komisioni, gjatë përgatitjes dhe hartimit të akteve të deleguara, duhet të sigurojë një transmetim të njëkohshëm, në kohën dhe mënyrën e duhur, të dokumenteve përkatëse pranë Parlamentit Evropian dhe Këshillit.

41. Për zbatimin e kësaj rregulloreje, duke përfshirë përgatitjen e akteve të deleguara, Komisioni duhet të konsultohet me ekspertë nga të gjitha shtetet anëtare.

42. Për të siguruar një zbatim të njëtrajtshëm, efikas dhe në kohë të dispozitave për mbështetjen operative të përcaktuar në këtë rregullore, kompetencat zbatuese duhet t'i jepen Komisionit. Këto kompetenca duhet të ushtrohen në përputhje me Rregulloren (BE) nr. 182/2011 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit¹³.

43. Duke qenë se qëllimi i kësaj rregulloreje, përkatësisht sigurimi i solidaritetit dhe ndarjes së përgjegjësisë ndërmjet shteteve anëtare dhe BE-së në menaxhimin e kufijve të jashtëm dhe politikave të vizave, nuk mund të arrihet mjaftueshëm nga shtetet anëtare dhe mund të arrihet më mirë në nivel Bashkimi Evropian, ky i fundit mund të miratojë masa në përputhje parimin e subsidiaritetit, siç përcaktohet në nenin 5 të TBE-së. Në përputhje me parimin e proporcionalitetit, sipas përcaktimit në atë nen, kjo rregullore nuk shkon përtej asaj që është e nevojshme për arritjen e këtij objekti.

44. Vendimi nr. 574/2007/KE duhet të shfuqizohet sipas dispozitave kalimtare të përcaktuara në këtë rregullore.

45. Për sa u përket Islandës dhe Norvegjisë, kjo rregullore përbën një zhvillim të tërësisë së legjislacionit të Shengenit sipas kuptimit të marrëveshjes së lidhur ndërmjet Këshillit të Bashkimit Evropian dhe Republikës së Islandës dhe Mbretërisë së Norvegjisë për asociimin e këtyre të fundit në implementimin, zbatimin dhe zhvillimin e tërësisë së legjislacionit¹⁴ të Shengenit, i cili përfshihet në fushën e përmendur në nenin 1, pikat "A" dhe "B" të Vendimit të Këshillit 1999/437/KE¹⁵.

46. Për sa i përket Zvicrës, kjo rregullore përbën një zhvillim të dispozitave të tërësisë së legjislacionit të Shengenit sipas kuptimit të marrëveshjes së lidhur ndërmjet Bashkimit Evropian, Komunitetit Evropian dhe Konfederatës Zvicerane për asociimin e Konfederatës Zvicerane në implementimin, zbatimin dhe zhvillimin e tërësisë së legjislacionit¹⁶ të Shengenit, të cilat përfshihen në fushën e përmendur në nenin 1, germa "A" dhe "B" të Vendimit 1999/437/KE që lexohet i lidhur me nenin 3 të Vendimit të Këshillit 2008/146/KE¹⁷.

47. Për sa i përket Lihtenshtejnit, kjo rregullore përbën një zhvillim të dispozitave të tërësisë së legjislacionit të Shengenit sipas kuptimit të Protokollit ndërmjet Bashkimit Evropian, Komunitetit Evropian, Konfederatës Zvicerane dhe Principatës së Lihtenshtejnit për aderimin e Principatës së Lihtenshtejnit në marrëveshjen ndërmjet Bashkimit Evropian, Komunitetit Evropian dhe Konfederatës Zvicerane për asociimin e Konfederatës Zvicerane në implementimin, zbatimin dhe zhvillimin e Shengenit¹⁸ të cilat përfshihen në fushën e përmendur në nenin 1, germa "A" të Vendimit 1999/437/KE, që lexohet i lidhur me nenin 3 të Vendimit të Këshillit 2011/350/BE¹⁹.

48. Në përputhje me nenin 1 dhe 2 të Protokollit nr. 22 "Për qëndrimin e Danimarkës", bashkëlidhur si shtojcë TBE-së dhe TFBE-së, Danimarka nuk merr pjesë në miratimin e kësaj rregulloreje dhe nuk është e detyruar ta zbatojë atë apo të jetë objekt i zbatimit të saj. Duke qenë se kjo rregullore bazohet mbi tërësinë e legjislacionit të Shengenit, Danimarka, në përputhje me nenin 4 të këtij protokollit dhe brenda gjashtë muajsh pasi Këshilli ka marrë vendimin për këtë rregullore, do të vendosë nëse do ta implementojë atë në legjislacionin e saj të brendshëm.

49. Kjo rregullore përbën një zhvillim të dispozitave të tërësisë së legjislacionit të Shengenit në të cilën Mbretëria e Bashkuar nuk merr pjesë, në përputhje me Vendimin e Këshillit 2000/365/KE²⁰; ndaj Mbretëria e Bashkuar nuk merr pjesë në miratimin e saj dhe nuk është e detyruar ta zbatojë atë apo të jetë objekt i zbatimit të saj.

50. Kjo rregullore përbën një zhvillim të dispozitave të tërësisë së legjislacionit të Shengenit në të cilën Irlanda nuk merr pjesë, në përputhje me Vendimin e Këshillit 2002/192/KE²¹. Për rrjedhojë, Irlanda nuk merr pjesë në miratimin e këtij legjislacioni dhe nuk i nënshtrohet detyrimeve apo zbatimit të tij.

51. Është me vend që periudha e zbatimit të kësaj rregulloreje të bashkërendohet me atë të zbatimit të Rregullores së Këshillit (BE, Euratom) nr. 1311/2013²². Për rrjedhojë, zbatimi i kësaj rregulloreje duhet të fillojë nga data 1 janar 2014.

MIRATOJNË KËTË RREGULLORE:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi dhe fusha e zbatimit

1. Kjo rregullore krijon instrumentin e mbështetjes financiare për menaxhimin e kufijve të jashtëm dhe politikën e përbashkët të vizave ("Instrumenti") si pjesë e Fondit për Sigurinë e Brendshme ("Fondi").

Së bashku me Rregulloren (BE) 513/2014, kjo rregullore themelon Fondin për periudhën prej 1 janarit 2014 deri më 31 dhjetor 2020.

2. Kjo rregullore përcakton:

- a) objektivat e mbështetjes financiare dhe masat përfituese;
- b) kuadrin e përgjithshëm për zbatimin e masave përfituese;
- c) burimet e vëna në dispozicion sipas Instrumentit nga data 1 janar 2014 deri më 31 dhjetor 2020 dhe shpërndarja e tyre;
- d) fushën e zbatimit dhe qëllimin e mjeteve të ndryshme specifike përmes të cilave financohen shpenzimet për menaxhimin e kufijve të jashtëm dhe politikat e përbashkëta të vizave.

3. Kjo rregullore garanton zbatimin e rregullave të përcaktuara në Rregulloren (BE) nr. 514/2014.

Neni 2

Përkufizime

Për qëllimet e kësaj rregulloreje përdoren përkufizimet e mëposhtme:

a) "kufij të jashtëm" janë kufijtë tokësorë të shteteve anëtare, duke përfshirë kufijtë lumorë dhe liqenorë, kufijtë detarë dhe aeroportet e tyre, portet lumore, portet detare dhe portet liqenore për të cilat zbatohen dispozitat e legjislacionit të BE-së mbi kalimin e kufijve të jashtëm, qofshin ato kufij të përkohshëm ose jo;

b) "standardet e përbashkëta të BE-së" janë zbatimi i masave operationale në një mënyrë të përbashkët dhe të pafragmentuar për të përfutur një nivel të lartë dhe të njëtrajtshëm sigurie në fushën e kontrollit kufitar dhe vizave në përputhje me Rregulloren (KE) nr. 562/2006 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit²³, Rregulloren (KE) nr. 810/2009 e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit²⁴, Rregulloren (KE) nr. 767/2008 e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit²⁵, Rregulloren (KE) nr. 2007/2004, Rregulloren (KE) nr. 1931/2006 e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit²⁶, katalogun e Shengenit për kontrollin e kufijve të jashtëm, Manualin Praktik për rojat kufitare, Manualin për vizat, Manualin e Eurosur-it dhe të gjithë Rregulloret dhe udhëzimet për t'u miratuar në nivel BE-je për kontrollin kufitar dhe vizat;

c) "kufij të jashtëm të përkohshëm" janë:

I. kufiri i përbashkët midis një shteti anëtar që po zbaton plotësisht tërësinë e legjislacionit të Shengenit dhe një shteti anëtar që është i detyruar të zbatojë tërësinë e

legjislacionit të Shengenit plotësisht, në përputhje me Aktin e Anëtarësimit të tij, por për të cilin Vendimi përkatës i Këshillit që e autorizon ta zbatojë plotësisht atë tërësi legjislacioni nuk ka hyrë në fuqi;

II. kufiri i përbashkët midis dy shteteve anëtare të detyruara të zbatojnë plotësisht tërësinë e legjislacionit të Shengenit, në përputhje me Aktin përkatës të e Anëtarësimit të tyre, por për të cilin Vendimi përkatës i Këshillit që i autorizon ta zbatojnë plotësisht atë legjislacion ende nuk ka hyrë në fuqi;

d) "pika e kalimit kufitar" është çdo pikë kalimi e autorizuar nga autoritetet kompetente për kalimin e kufijve të jashtëm sipas njoftimit në përputhje me nenin 34, paragrafi 2 të Rregullores (KE) nr. 562/2006;

e) "mekanizmi i Shengenit për vlerësim dhe monitorim" është verifikimi i zbatimit korrekt të tërësisë së legjislacionit të Shengenit siç është përcaktuar në Rregulloren (BE) nr. 1053/2013;

f) "situatë emergjente" është një situatë që lind nga një presion urgjent dhe i jashtëzakonshëm ku një numër i lartë dhe jo proporcional shtetasish të një vendi të tretë po kalojnë apo priten të kalojnë kufirin e jashtëm të një apo më shumë shteteve anëtare apo çdo situatë tjetër emergjente e justifikuar siç duhet që kërkon një veprim urgjent në kufijtë e jashtëm;

g) "seksioni i kufijve të jashtëm" është një pjesë apo tërësia e kufirit të jashtëm tokësor apo detar e një shteti anëtar sipas përkufizimit në legjislacionin e brendshëm ose sipas përcaktimit nga qendra kombëtare për koordinim ose çdo autoritet tjetër përgjegjës kombëtar për qëllimin e zbatimit të Rregullores (BE) nr. 1052/2013.

Neni 3

Objektivat

1. Objektiv i përgjithshëm i Instrumentit është kontributi në garantimin e një niveli të lartë sigurie në BE ndërsa lehtëson udhëtimin e ligjshëm, nëpërmjet një kontrolli të njëtrajtshëm dhe me nivel të lartë të kufijve të jashtëm dhe përpunimin e efektshëm të vizave Shengen, në përputhje me angazhimin e BE-së ndaj lirive dhe të drejtave themelore të njeriut.

2. Brenda objektivit të përgjithshëm të përcaktuar në paragrafin 1, Instrumenti kontribuon - në përputhje me prioritetet e identifikuar në strategjitë, programet, vlerësimet e kërcënimeve dhe vlerësimet e rrezikut përkatëse të BE-së - në përmbushjen e objektivave specifike si në vijim:

a) mbështetjen e një politike të përbashkët të vizave për të lehtësuar udhëtimin e ligjshëm, për të siguruar një shërbim me cilësi të lartë për aplikuesit për viza, për të garantuar trajtim të barabartë të shtetasve të vendeve të treta dhe për të gjurmuar emigracionin e paligjshëm;

b) mbështetjen e menaxhimit të integruar të kufijve, përfshirë nxitjen e harmonizimit të mëtejshëm të masave që lidhen me menaxhimin e kufijve në përputhje me standardet e

përbashkëta të BE-së dhe nëpërmjet shkëmbimit të informacionit midis shteteve anëtare dhe midis shteteve anëtare dhe Agjencisë Frontex, për të siguruar, në një anë, një njëtrajtshmëri dhe nivel të lartë kontrolli dhe mbrojtjeje të kufijve të jashtëm, përfshirë gjurmimin e emigracionit të paligjshëm dhe, nga ana tjetër, kalimin pa probleme të kufijve të jashtëm në përputhje me tërësinë e legjislacionit të Shengenit, ndërkohë që garanton akses në mbrojtjen ndërkombëtare për ata që kanë nevojë për të, në përputhje me detyrimet e marra përsipër nga shtetet anëtare në fushën e të drejtave të njeriut, përfshirë parimin e moskthimit.

Arritja e objektivave specifike të Instrumentit vlerësohet në përputhje me nenin 55, paragrafi 2 të Rregullores (BE) nr. 514/2014 duke përdorur tregues të përbashkët, siç janë vendosur në shtojcën IV të kësaj Rregulloreje dhe tregues specifikë të programit të përfshirë në programet kombëtare.

3. Për të arritur objektivat e përmendur në paragrafët 1 dhe 2, Instrumenti kontribuon në objektivat e mëposhtëm operacionale:

a) nxitjen e zhvillimit, implementimit dhe zbatimit të politikave me synim garantimin e mungesës së kontroleve për personat, cilado qoftë shtetësia e tyre, kur kalojnë kufijtë e brendshëm dhe kryerjen e verifikimeve për personat dhe monitorimin efikas të kalimit të kufijve të jashtëm;

b) vendosjen graduale të një sistemi të integruar për menaxhimin e kufijve të jashtëm, bazuar në solidaritet dhe përgjegjësi, në veçanti me anë të:

I. forcimit të kontrollit në kufijtë e jashtëm dhe sistemet e mbikëqyrjes dhe të bashkëpunimit ndërmjet agjencive të rojave kufitare, autoriteteve doganore, të emigracionit, azilit dhe zbatimit të ligjit të shteteve anëtare në kufijtë e jashtëm, përfshirë zonat e kufijve detare;

II. masat brenda territorit që lidhen me menaxhimin e kufijve të jashtëm dhe masat e nevojshme shoqëruese për sigurinë e dokumenteve, menaxhimin e identitetit dhe ndërveprimin e pajisjeve teknike të blera;

III. të gjithë masat që kontribuojnë gjithashtu në parandalimin dhe luftën kundër krimit ndërkufitar në kufijtë e jashtëm që lidhen me lëvizjen e personave, përfshirë trafikimin e qenieve njerëzore dhe kontrabandimit të njerëzve;

c) promovimit të zhvillimit dhe zbatimit të politikave të përbashkëta të vizave dhe lejeve të tjera të qëndrimit afatshkurtër dhe të formave të ndryshme të bashkëpunimit konsullor me qëllim që të garantojnë mbulim më të mirë konsullor dhe praktika të harmonizuara për lëshimin e vizave;

d) krijimit dhe përdorimit të sistemeve të IT-së, infrastrukturës së tyre të komunikimit dhe pajisjeve që mbështesin politikat e përbashkëta të vizave, verifikimet kufitare dhe mbikëqyrjen kufitare në kufijtë e jashtëm dhe që respektojnë ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale;

e) forcimit të ndërgjegjësimit ndaj situatës në kufijtë e jashtëm dhe kapacitetet reaguese të shteteve anëtare;

f) sigurimit të zbatimit efikas dhe të njëtrajtshëm të tërësisë së legjislacionit të BE-së për kufijtë dhe vizat, përfshirë funksionimin e efektshëm të mekanizimit të Shengenit për vlerësimin dhe monitorimin;

g) forcimit të veprimeve nga shtete anëtare që kontribuojnë në nxitjen e bashkëpunimit midis shteteve anëtare që veprojnë në vende të treta në lidhje me flukset e shtetasve të vendeve të treta drejt territorit të shteteve anëtare, përfshirë parandalimin dhe gjurmimin e emigracionit të paligjshëm, si dhe bashkëpunimin me vende të treta në këtë aspekt në koherencë të plotë me objektivat dhe parimet e politikës së jashtme dhe humanitare të BE-së.

4. Veprimet e financuara sipas Instrumentit zbatohen në përputhje të plotë me të drejtat themelore dhe respektin për dinjitetin njerëzor. Në veçanti, veprimet janë në pajtim me dispozitat e Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian, ligjin e BE-së për mbrojtjen e të dhënave, Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ), parimin e trajtimit të drejtë të shtetasve të vendeve të treta, të drejtën për azil dhe mbrojtje ndërkombëtare, parimin e moskthimit dhe detyrimet ndërkombëtare të BE-së dhe shteteve anëtare që lindin nga instrumentet ndërkombëtare në të cilat ato janë nënshkruese si Konventa e Gjenevës në Lidhje me Statusin e Refugjatëve e 28 korrikut 1951, e plotësuar nga Protokollin i Nju-Jorkut i datës 31 janar 1967.

Në veçanti, kurdoherë që është e mundur, vëmendje e veçantë duhet t'u jepet shteteve anëtare gjatë zbatimit të veprimeve për identifikimin, ndihmën e menjëhershme dhe referimin ndaj shërbimeve të mbrojtjes të personave në nevojë, veçanërisht fëmijëve dhe të miturve të pashoqëruar.

5. Gjatë zbatimit të veprimeve të financuara sipas instrumentit të cilat janë të lidhura me mbikëqyrjen e kufijve detare, shtetet anëtare u kushtojnë vëmendje të veçantë detyrimeve të tyre sipas legjislacionit ndërkombëtar detar për t'u dhënë ndihmë personave në vështirësi. Në këtë aspekt, pajisjet dhe sistemet e mbështetura nga Instrumenti mund të përdoren për t'iu përgjigjur situatave të kërkimit dhe të shpëtimit të cilat mund të lindin gjatë një operacioni mbikëqyrës në det, duke kontribuar kështu në garantimin e mbrojtjes dhe shpëtimit të jetëve të emigrantëve.

6. Instrumenti kontribuon gjithashtu në financimin e asistencës teknike me iniciativë të shteteve anëtare dhe Komisionit.

Neni 4

Masat përfituese

1. Në objektivat e përmendura në nenin 3 të kësaj Rregulloreje dhe në kuadër të rezultateve të dialogut politik sipas nenit 13 të Rregullores (BE) nr. 514/2014 dhe në përputhje me objektivat e programit kombëtar të përmendur në nenin 9 të kësaj rregulloreje, Instrumenti mbështet veprimet në ose nga shtetet anëtare, veçanërisht të mëposhtmet:

a) infrastrukturat, ndërtesat dhe sistemet e nevojshme në pikat e kalimit kufitar dhe për mbikëqyrje midis pikave të kalimit kufitar për të parandaluar dhe gjurmuar kalime të paautorizuara të kufirit, emigracionin e jashtëligjshëm dhe kriminalitetin ndërkufitar si dhe për të garantuar flukse udhëtimi pa probleme;

b) pajisjet, mjetet e transportit dhe sistemet e komunikimi të nevojshme për kontrollin efikas dhe të sigurt kufitar dhe zbulimin e personave;

c) sistemet e IT-së dhe të komunikimit për menaxhimin efikas të flukseve të emigracionit përmes kufijve, përfshirë investimet në sistemet ekzistuese dhe të ardhme;

d) infrastrukturat, ndërtesat dhe sistemet e komunikimit dhe të IT-së dhe pajisjet që nevojiten për përpunimin e aplikimeve për vizë dhe operacioneve konsullore, si dhe veprime të tjera që synojnë të përmirësojnë cilësinë e shërbimeve për aplikuesit për vizë;

e) trajnimin në përdorimin e pajisjeve dhe sistemeve të përmendura në gerrat "b", "c" dhe "d" dhe promovimin e cilësisë së standardeve të menaxhimit dhe trajnimit të rojave kufitare, përfshirë aty ku është e përshtatshme në vendet e treta, lidhur me përmbushjen e detyrave të tyre mbikëqyrëse, këshillimore dhe kontrolluese në përputhje me të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, përfshirë identifikimin e viktimave të trafikimit njerëzor dhe kontrabandimin e njerëzve;

f) transferimin e koordinatorëve të emigracionit dhe këshilluesve për dokumentet në vendet e treta dhe shkëmbimin e mbështetjen e rojave kufitare midis shteteve anëtare ose midis një shteti anëtar dhe një vendi të tretë;

g) studimet, trajnimin, projektet pilot dhe veprimet e tjera që vendosin gradualisht një sistem të integruar menaxhimi për kufijtë e jashtëm sipas nenit 3, paragrafi 3, përfshirë veprimet që kanë për synim nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet agjencive qoftë brenda shteteve anëtare ose midis shteteve anëtare dhe veprimet që lidhen me ndërfunksionimin dhe harmonizimin e sistemeve të menaxhimit kufitar;

h) studimet, projektet pilot dhe veprimet që synojnë të zbatojnë rekomandimet, standardet operacionale dhe praktikat më të mira që rezultojnë nga bashkëpunimi operacional midis shteteve anëtare dhe agjencive të BE-së.

2. Në objektivat e përmendura në nenin 3 të kësaj Rregulloreje dhe në kuadër të rezultateve të dialogut politik sipas nenit 13 të Rregullores (BE) nr. 514/2014 dhe në përputhje me objektivat e programit kombëtar të përmendur në nenin 9 të kësaj rregulloreje, Instrumenti mbështet veprimet në lidhje me ose nga shtetet anëtare dhe veçanërisht të mëposhtmet:

a) sistemet e informacionit, mjetet ose pajisjet për shkëmbimin e informacionit midis shteteve anëtare dhe vendeve të treta;

b) veprimet që lidhen me bashkëpunimin operacional midis shteteve anëtare dhe vendeve të treta, përfshirë operacionet e përbashkëta;

c) projektet në vendet e treta që synojnë përmirësimin e sistemeve të mbikëqyrjes për të siguruar bashkëpunimin me Eurosur-in;

d) studimet, seminarët, konferencat, trajnimet, pajisjet dhe projektet pilot për të siguruar ekspertizë të posaçme teknike dhe operacionale për vendet e treta;

e) studimet, seminarët, konferencat, trajnimet, pajisjet dhe projektet pilot që zbatojnë rekomandime specifike, standarde operacionale dhe praktikat më të mira që rezultojnë nga bashkëpunimi operacional midis shteteve anëtare dhe agjencive të BE-së në vendet e treta.

Komisioni dhe shtetet anëtare, së bashku me Shërbimin Evropian të Veprimit të Jashtëm, sigurojnë koordinimin për sa u përket veprimeve në dhe në lidhje me vende të treta, siç parashikohet në nenin 3, paragrafi 5 i Rregullores (BE) nr. 514/2014.

3. Nuk pranohen në kufijtë e jashtëm të përkohshëm veprimet e përmendura në germën "a" të paragrafit 1.

4. Nuk pranohen veprimet që lidhen me rifutjen e përkohshme dhe të jashtëzakonshme të kontrollit kufitar në kufijtë e brendshëm sipas Kodit për Kufijtë e Shengenit.

5. Nuk pranohen veprimet, synimi ose efekti ekskluziv i të cilave është kontrolli i të mirave.

KREU II

KUADRI FINANCIAR DHE I ZBATIMIT

Neni 5

Burimet globale dhe zbatimi

1. Burimet globale për zbatimin e Instrumentit janë 2760 milionë euro me çmimet aktuale.

2. Shumat e caktuara vjetore autorizohet nga Parlamenti Evropian dhe nga Këshilli brenda kufijve të kuadrit financiar shumëvjeçar.

3. Burimet globale zbatohen nëpërmjet mënyrave të mëposhtme:

a) programeve kombëtare, në përputhje me nenet 9 dhe 12;

b) mbështetjes operacionale, në kuadër të programeve kombëtare dhe sipas kushteve të përcaktuara në nenin 10;

c) Skemës së Veçantë të Transitit, në përputhje me nenin 11;

d) veprimeve të BE-së, në përputhje me nenin 13;

e) asistencës emergjente, në përputhje me nenin 14;

f) zbatimit të një programi për vendosjen e sistemeve IT që mbështesin menaxhimin e flukseve të emigracionit përmes kufijve të jashtëm sipas kushteve të përcaktuara në nenin 15;

g) asistencës teknike në përputhje me nenin 16.

4. Buxheti që alokohet sipas Instrumentit për veprimet e BE-së të përmendura në nenin 13 të kësaj rregulloreje, për ndihmën emergjente të përmendur në nenin 14 të kësaj rregulloreje dhe për asistencën teknike të përmendur në nenin 16, paragrafi 1 të kësaj rregulloreje, zbatohet nën menaxhim të drejtpërdrejtë në përputhje me germën "a" të nenit 58, paragrafi 1 i Rregullores (BE, Euratom) nr. 966/2012 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit²⁷ dhe sipas rastit, nën menaxhim të drejtpërdrejtë në përputhje me germën "c"²⁷ dhe sipas rastit, nën menaxhim të drejtpërdrejtë në përputhje me germën "c" të nenit 58, paragrafi 1 të Rregullores (BE, Euratom) nr. 966/2012.

Buxheti që u alokohet programeve kombëtare të përmendura në nenin 9 për sistemin operativ të përmendur në nenin 10 dhe për funksionimin e Skemës së Veçantë të Transitit të përmendur në nenin 11, zbatohet nën menaxhim të drejtpërdrejtë në përputhje me germën "b" të nenit 58, paragrafi 1 të Rregullores (BE, Euratom) nr. 966/2012.

Buxheti që u alokohet vendeve të asociuara me implemetimin, zbatimin dhe zhvillimin e tërësisë së legjislacionit të Shengenit të përmendur në paragrafin 7 të këtij neni, zbatohet nën menaxhim të tërthortë në përputhje me germat "c" dhe "i" të nenit 58, paragrafi 1 të Rregullores (BE, Euratom) nr. 966/2012.

Metodat e zbatimit të buxhetit për programin e zhvillimit të sistemeve të IT-së, bazuar në sistemet ekzistuese dhe/ose ato të reja të IT-së, përcaktohen në aktet ligjore përkatëse të BE-së pas miratimit të tyre.

5. Burimet globale përdoren si më poshtë:

a) 1551 milionë euro për programet kombëtare të shteteve anëtare;

b) 791 milionë euro për zhvillimin e sistemeve të IT-së, bazuar në sistemet ekzistuese dhe/ose ato të reja të IT-së, duke mbështetur menaxhimin e flukseve të emigracionit përmes kufijve të jashtëm, objekt i miratimit të akteve ligjore përkatëse të BE-së;

Kur kjo shumë nuk alokohet ose nuk shpenzohet, Komisioni, me anë të një akti të deleguar në përputhje me nenin 17, e rialokon atë në një ose më shumë aktivitete të përmendura në germat "b" dhe "c" të nenit 6, paragrafi 1 dhe germa "d" e këtij paragrafi. Ky akt i deleguar duhet të përfshijë një vlerësim të evoluimit të sistemeve përkatëse të IT-së duke përfshirë zbatimin e buxhetit dhe shumat e pashpenzuara të pritura. Ky rialokim mund të ndodhë pas miratimit të akteve përkatëse ligjore ose në rastin e rishikimit afatmesëm të përmendur në nenin 8.

c) 154 milionë euro për Skemën e Veçantë të Transitit;

d) 264 milionë euro për veprimet e BE-së, ndihmën emergjente dhe asistencën teknike me iniciativë të Komisionit, të paktën 30 % e të cilave përdoret për veprimet e BE-së.

6. Së bashku me burimet globale të përcaktuara për Rregulloren (BE) nr. 513/2014, burimet globale të disponueshme për Instrumentin, të përcaktuara në paragrafin 1, përbëjnë zarin financiar për Fondin dhe shërbejnë si referencë kryesore, në kuptim të pikës 17 të Marrëveshjes Ndërinstitucionale të datës 2 dhjetor 2013 ndërmjet Parlamentit Evropian, Këshillit dhe Komisionit për disiplinën buxhetore, për bashkëpunimin në çështjet buxhetore dhe menaxhimin e shëndoshë financiar²⁸, për Parlamentin Evropian dhe Këshillin gjatë procedurës vjetore buxhetore.

7. Vendet e lidhura me implementimin zbatimin dhe zhvillimin e tërësisë së legjislacionit të Shengenit marrin pjesë në Instrument sipas kësaj rregulloreje.

Vendosen masa për kontributin financiar të këtyre vendeve në Instrument dhe rregullat plotësuese të nevojshme për një pjesëmarrje të tillë, duke përfshirë dispozitat që sigurojnë mbrojtjen e interesave financiare të BE-së dhe kompetencën e Gjykatës së Audituesve për të audituar.

Kontributet financiare të atyre vendeve i shtohen burimeve globale në dispozicion nga buxheti i BE-së i përmendur në paragrafin 1.

Neni 6

Burimet për masat përfituese në shtetet anëtare

1. Shteteve anëtare u alokohen 1551 milionë euro përkatësisht si më poshtë:

a) 1276 milionë euro, siç tregohet në shtojcën I;

b) 147 milionë euro, bazuar në rezultatet e mekanizmit të përmendur në nenin 7;

c) në kuadrin e rishikimit afatmesëm të përmendur në nenin 8 dhe për periudhën nga viti buxhetor 2018, 128 milionë euro, pjesa tjetër e ndarjeve buxhetore në dispozicion sipas këtij neni ose një shumë tjetër, siç është përcaktuar në paragrafin 4, bazuar në rezultatet e analizës së rrezikut dhe rishikimin afatmesëm.

2. Secili shtet anëtar alokon shumat bazë për programet kombëtare të treguara në shtojcën I si më poshtë:

a) të paktën 10% për veprimet që lidhen me germën "a" të nenit 9, paragrafi 2;

b) të paktën 25 % për veprimet që lidhen me germën "b" të nenit 9, paragrafi 2;

c) të paktën 5 % për veprimet që lidhen me gjerat "c", "d", "e" dhe "f" të nenit 9, paragrafi 2;

Shtetet anëtare mund të devijojnë nga ato përqindje minimale, me kusht që të përfshihet një shpjegim në programin kombëtar për arsyen se pse alokimi i burimeve nën ato minimale nuk rrezikon arritjen e objektivit përkatës. Ky shpjegim vlerësohet nga Komisioni në kuadrin e miratimit të programeve kombëtare siç referohet në nenin 9, paragrafi 2.

3. Shtetet anëtare i kushtojnë fondet e nevojshme Eurosur-it për të siguruar mbarëvajtjen e tij.

4. Për të trajtuar siç duhet objektivat e Instrumentit në rast të rrethanave të paparashikuara ose të reja dhe/ose për të siguruar zbatimin efektiv të fondeve të disponueshme në kuadër të Instrumentit, Komisioni autorizohet të miratojë aktet e deleguara në përputhje me nenin 17 për të axhustuar shumën treguese të përcaktuar në germën "c" të paragrafit 1 të këtij neni.

5. Shtetet anëtare që aderojnë në BE në periudhën 2012-2020 nuk përfitojnë nga alokimet për programet kombëtare sipas Instrumentit për sa kohë që përfitojnë nga një instrument i përkohshëm i BE-së i cili mbështet shtetet anëtare përfituese për të financuar veprimet në kufijtë e rinj të jashtëm për zbatimin e tërësisë së legjislacionit për kufijtë dhe vizat dhe kontrollin e kufirit të jashtëm.

Neni 7

Burimet për masa specifike

1. Përveç alokimit të tyre të llogaritur në përputhje me germën "a" të nenit 6, paragrafi 1, shtetet anëtare mund të marrin një shumë shtesë, me kusht që ajo të jetë e rezervuar si e tillë në programin kombëtar dhe duhet të përdoret për të arritur masat specifike të renditura në shtojcën II.

2. Komisioni autorizohet të miratojë akte të deleguara në përputhje me nenin 17 për rishikimin e masave specifike të renditura në shtojcën II, nëse konsiderohet e përshtatshme, duke përfshirë edhe në kontekstin e rishikimit afatmesëm. Në bazë të masave të reja specifike, shtetet anëtare mund të marrin një shumë shtesë sipas paragrafit 1 të këtij neni, në varësi të burimeve në dispozicion.

3. Shumat shtesë sipas këtij neni u alokohen shteteve anëtare të përfshira në vendimin e financimit individual që miraton ose rishikon programin e tyre kombëtar në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 14 të Rregullores (BE) nr. 514/2014.

Neni 8

Burimet në kuadër të rishikimit afatmesëm

1. Për të alokuar shumën e treguar në germën "c" të nenit 6, paragrafi 1, deri më 1 qershor 2017, Komisioni merr parasysh barrën e shteteve anëtare në menaxhimin e kufirit, duke përfshirë aktivitetet e kërkim-shpëtimit që mund të lindin gjatë operacioneve të mbikëqyrjes së kufirit në det dhe raportet e vlerësimit të hartuara si pjesë e mekanizmit të Shengenit për vlerësim dhe monitorim, si dhe nivelet e kërcënimit në kufijtë e jashtëm për periudhën 2017-2020, si dhe faktorët që preknin sigurinë në kufijtë e jashtëm në periudhën 2014-2016. Kjo shumë alokohet ndërmjet shteteve anëtare në bazë të përqindjes së kategorive të mëposhtme të kufijve, duke marrë parasysh paragrafin 6 të këtij neni:

a) 45 % për kufijtë detarë;

b) 38 % për kufijtë tokësorë;

c) 17 % për aeroportet.

2. Për kufijtë e jashtëm detarë dhe tokësorë, llogaritja e shumës bazohet në gjatësinë e seksioneve të kufirit të jashtëm të shumëzuar me një nivel kërcënimi (minimal, normal, mesatar, i lartë) për çdo seksion kufitar, si më poshtë:

a) koeficienti 0,5 për nivel minimal të kërcënimit;

b) koeficienti 1 për nivel normal të kërcënimit;

c) koeficienti 3 për nivel mesatar të kërcënimit;

d) koeficienti 5 për nivel të lartë të kërcënimit.

3. Për aeroportet, alokimi përlllogaritet për çdo shtet anëtar si më poshtë:

a) 50 % në bazë të numrit të personave që kalojnë kufijtë e jashtëm;

b) 50 % në bazë të numrit të shtetasve të vendeve të treta të cilëve ju është refuzuar hyrja në kufijtë e jashtëm.

4. Në përputhje me raportin e analizës së rrezikut të Agjencisë Frontex dhe në konsultim me të dhe, sipas rastit, me agjencitë e tjera të BE-së, Komisioni përcakton nivelet e kërcënimit për çdo seksion kufitar të jashtëm të shteteve anëtare për periudhën 2017-2020. Nivelet e kërcënimit bazohen në faktorët e mëposhtëm:

a) barrën në menaxhimin e kufijve në kufijtë e jashtëm;

b) faktorët që prekën sigurinë në kufijtë e jashtëm të shteteve anëtare në periudhën 2014-2016;

c) ndryshimet në politikat e BE-së, për shembull politikat për vizat;

d) tendencat e mundshme të ardhshme në flukset migratore dhe rreziqet e aktiviteteve të paligjshme lidhur me kalimin e parregullt të personave në kufijtë e jashtëm; dhe

e) zhvillimet e mundshme politike, ekonomike dhe sociale në vendet e treta, dhe në veçanti, vendet fqinje.

Para se të nxjerrë raportin e tij për përcaktimin e niveleve të kërcënimit, Komisioni organizon një shkëmbim pikëpamjesh me shtetet anëtare.

5. Për qëllimet e shpërndarjes së burimeve sipas paragrafit 1:

a) merret parasysh vija midis zonave të përmendura në nenin 1 të Rregullores së Këshillit (KE) nr. 866/2004²⁹, por jo kufiri detar në veri të asaj vije, edhe pse ajo nuk përbën një kufi

tokësor të jashtëm për sa kohë është në fuqi neni 1 i protokollit nr. 10 për Qipron në Aktin e Anëtarësimit të vitit 2003;

b) shprehja "kufijtë e jashtëm detarë" nënkupton kufirin e jashtëm të detit territorial të shteteve anëtare siç përcaktohet në përputhje me nenet 4 deri 16 të Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtën e Detit. Megjithatë, në rastet kur operacionet me rreze të gjatë kërkohen rregullisht për të parandaluar kalimet kufitare të paautorizuara, kjo shprehje ka kuptimin ekstremi i jashtëm i zonave të kërcënimit të lartë. Këto ekstreme të jashtme përcaktohen duke marrë parasysh të dhënat përkatëse për këto operacione në periudhën 2014-2016 siç parashikohet nga shtetet anëtare në fjalë.

6. Gjithashtu, përpara 1 qershorit 2017, pas ftesës nga Komisioni shtetet anëtare mund të marrin një alokim shtesë, me kusht që të jetë i rezervuar si i tillë në programin kombëtar dhe duhet të përdoret për të arritur masa specifike që do të krijohen në kuadër të prioriteteve të BE-së në atë kohë.

7. Shumat shtesë sipas këtij neni u alokohen shteteve anëtare të përfshira në vendimin e financimit individual që miraton ose rishikon programin e tyre kombëtar në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 14 të Rregullores (BE) nr. 514/2014.

Neni 9

Programet kombëtare

1. Programi kombëtar që do të përgatitet, duke marrë parasysh rezultatin e dialogut politik të përmendur në nenin 13 të Rregullores (BE) nr. 514/2014, sipas Instrumentit dhe ai që do të përgatitet sipas Rregullores (BE) nr. 513/2014 i propozohen Komisionit si një program i vetëm kombëtar për Fondin dhe në përputhje me nenin 14 të Rregullores (BE) nr. 514/2014.

2. Sipas programeve kombëtare që do të shqyrtohen dhe miratohen nga Komisioni në përputhje me nenin 14 të Rregullores (BE) nr. 514/2014, brenda objektivave të përmendura në nenin 3 të kësaj Rregulloreje dhe duke marrë parasysh rezultatin e dialogut politik të përmendur në nenin 13 të Rregullores (BE) nr. 514/2014, shtetet anëtare ndjekin në veçanti objektivat nga të mëposhtmet:

a) zhvillimin e Eurosur-it në përputhje me legjislacionin dhe udhëzimet e BE-së;

b) mbështetjen dhe zgjerimin e kapaciteteve ekzistuese në nivel kombëtar në politikat e vizave dhe në menaxhimin e kufijve të jashtëm, si dhe mbështetjen dhe zgjerimin e masave në fushën e lëvizjes së lirë në lidhje me menaxhimin e kufijve të jashtëm, duke pasur parasysh në veçanti teknologjinë e re, zhvillimet dhe/ose standardet në lidhje me menaxhimin e flukseve të emigracionit;

c) mbështetjen e zhvillimit të mëtejshëm të menaxhimit të flukseve të emigracionit nga shërbimet konsullore dhe të tjera të shteteve anëtare në vendet e treta, duke përfshirë krijimin e mekanizmave të bashkëpunimit konsullor me qëllim lehtësimin e udhëtimit të ligjshëm në përputhje me legjislacionin e BE-së ose me atë të shtetit anëtar në fjalë dhe duke parandaluar imigracionin e paligjshëm në BE;

d) përforcimin e menaxhimit të integruar të kufijve përmes testimit dhe futjes së mjeteve të reja, sistemeve ndërvepruese dhe metodave të punës të cilat synojnë të rrisin shkëmbimin e informacionit brenda shtetit anëtar ose të përmirësojnë bashkëpunimin ndërmjet agjencive;

e) zhvillimin e projekteve me qëllim të sigurimit të një niveli të njësuar dhe të lartë të kontrollit të kufirit të jashtëm në përputhje me standardet e përbashkëta të BE-së dhe me qëllim të rritjes së ndërveprimit të sistemeve të menaxhimit të kufijve midis shteteve anëtare;

f) mbështetjen e masave, pas konsultimit me agjencinë Frontex, me synim nxitjen e harmonizimit të mëtejshëm të menaxhimit të kufirit dhe të aftësive teknologjike në veçanti, në përputhje me standardet e BE-së;

g) sigurimin e zbatimit korrekt dhe të njëtrajtshëm të tërësisë së legjislacionit të BE-së për kontrollin kufitar dhe të vizave në përgjigje të mangësive të identifikuar në nivel BE-je, siç tregohet nga rezultatet e përcaktuara në kuadër të mekanizmit të Shengenit për vlerësim dhe monitorim;

h) ngritjen e kapaciteteve për të përballuar sfidat e ardhshme, duke përfshirë kërcënimet dhe presionet e tanishme dhe të ardhshme në kufijtë e jashtëm, duke marrë parasysh në veçanti analizat e kryera nga agjencitë përkatëse të BE-së.

3. Në ndjekje të objektivave të përmendura në paragrafin 2, shtetet anëtare mund të mbështesin veprimet në dhe në lidhje me vendet e treta sipas programeve të tyre kombëtare, duke përfshirë shkëmbimin e informacionit dhe bashkëpunimin operacional.

4. Komisioni konsultohet me Agjencinë Frontex për projekt-programet kombëtare, në veçanti për masat e financuara nga mbështetja operative, të paraqitura nga shtetet anëtare me qëllim të zhvillimit të komplementaritetit midis misionit të Agjencisë Frontex dhe përgjegjësive të shteteve anëtare për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufijve të jashtëm, si dhe për të siguruar qëndrueshmëri dhe për të shmangur joefikasitetin e kostos.

Neni 10

Mbështetja operative në zbatim të programeve kombëtare të shteteve anëtare

1. Një shtet anëtar mund të përdorë deri në 40% të shumës së alokuar në zbatim të Instrumentit në programin e tij kombëtar për të financuar mbështetjen operative për autoritetet publike përgjegjëse për kryerjen e detyrave dhe shërbimeve që përbëjnë një shërbim publik për BE-në.

2. Mbështetja operative ofrohet kur shteti anëtar në fjalë përmbush kushtet e mëposhtme:

a) pajtueshmëria me tërësinë e legjislacionit të BE-së për kufijtë dhe vizat;

b) pajtueshmëria me objektivat e programit kombëtar;

c) pajtueshmëria me standardet e përbashkëta të BE-së për të rritur koordinimin midis shteteve anëtare dhe për të shmangur duplikimin, fragmentizimin dhe joefikasitetin e kostos në fushën e kontrollit kufitar.

3. Për këtë qëllim, përpara miratimit të programit kombëtar, Komisioni vlerëson situatën bazë në shtetet anëtare të cilat kanë treguar synimin e tyre për të kërkuar mbështetje operative, duke marrë parasysh, sipas rastit, raportet e vlerësimit të Shengenit.

Gjetjet e Komisionit janë subjekt i një shkëmbimi të pikëpamjeve me shtetin anëtar në fjalë.

Pas shkëmbimit të pikëpamjeve, pranimi nga Komisioni i mbështetjes buxhetore brenda programit kombëtar të një shteti anëtar mund të kushtëzohet me programimin dhe përfundimin e një numri masash që synojnë të garantojnë përmbushjen e plotë të kushteve të përcaktuara në paragrafin 2 përpara se të ofrohet mbështetja buxhetore.

4. Mbështetja operative përqendrohet në detyra dhe/ose shërbime specifike dhe fokusohet në objektivat e përcaktuara në shtojcën III. Ajo përfshin rimbursimin e shpenzimeve të kryera për të përmbushur detyrat dhe/ose shërbimet e përcaktuara në programin kombëtar, brenda kufizimeve financiare të vendosur nga programi dhe tavanit i caktuar në paragrafin 1.

5. Mbështetja operative është subjekt i monitorimit dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet Komisionit dhe shtetit anëtar në fjalë në lidhje me situatën bazë në atë shtet anëtar, objektivat dhe synimet që duhet të arrihen dhe treguesit për matjen e progresit.

6. Komisioni vendos, nëpërmjet akteve zbatuese, procedurat e raportimit për zbatimin e kësaj dispozite dhe çdo masë tjetër praktike që do të vendoset midis shteteve anëtare dhe Komisionit në përputhje me këtë nen. Këto akte zbatuese miratohen në përputhje me procedurën e shqyrtimit të përmendur në nenin 18, paragrafi 2.

Neni 11

Mbështetja operative për Skemën e Veçantë të Transitit

1. Instrumenti siguron mbështetje për të kompensuar tarifat e mëparshme nga vizat e lëshuara për qëllime transiti dhe kostot shtesë të kryera gjatë zbatimit të skemës së Dokumentit për Lehtësimin e Transitit (DLT) dhe Dokumentit për Lehtësimin e Transitit Hekurudhor (DLTH) në përputhje me Rregulloren (KE) nr. 693/2003 dhe Rregulloren (KE) nr. 694/2003.

2. Burimet që i alokohen Lituanisë sipas paragrafit 1 nuk i kalojnë 154 milionë eurot për periudhën 2014-2020 dhe vihen në dispozicion si mbështetje e veçantë shtesë operative për Lituaninë.

3. Për qëllimet e paragrafit 1, kosto shtesë janë shpenzimet që rezultojnë drejtpërdrejt nga kërkesat specifike të zbatimit të veprimtarisë së Skemës së Veçantë të Transitit dhe të cilat nuk krijohen si rezultat i dhënies së vizave për qëllime transiti ose qëllime të tjera.

Llojet e mëposhtme të kostove shtesë pranohen për financim:

- a) investime në infrastrukturë;
- b) trajnim i stafit që zbaton skemën e veçantë të transitit;
- c) kosto shtesë operative, përfshirë pagat e stafit që zbaton skemën e veçantë të transitit.

4. Tarifat e mëparshme që përmenden në paragrafin 1 të këtij neni llogariten në bazë të nivelit të tarifave të vizave dhe pagesës së tarifës së vizës, të përcaktuar në Marrëveshjen midis Bashkimit Evropian dhe Federatës Ruse "Për lehtësimin e lëshimit të vizave për qytetarët e Bashkimit Evropian dhe të Federatës Ruse"³⁰, brenda kuadrit financiar të përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni.

5. Komisioni dhe Lituania rishikojnë zbatimin e këtij neni në rast të ndryshimeve që kanë ndikim në ekzistencën dhe/ose funksionimin e skemës së veçantë të transitit.

6. Komisioni vendos, nëpërmjet akteve zbatuese, procedurat e raportimit për zbatimin e kësaj dispozite dhe çdo marrëveshje tjetër financiare dhe praktike që do të lidhet midis Litanisë dhe Komisionit në përputhje me këtë nen. Këto akte zbatuese miratohen në përputhje me procedurën e shqyrtimit të përmendur në nenin 18, paragrafi 2.

7. Për të siguruar mbarëvajtjen e Skemës së Veçantë të Transitit, Komisioni mund të vendosë masa specifike të pagesave të përkohshme të cilat derogojnë nga dispozitat e Rregullores (BE) nr. 514/2014.

Neni 12

Programimi në përputhje me rezultatet e mekanizmit të Shengenit për vlerësim dhe monitorim

Pas një raporti të vlerësimit të Shengenit, i miratuar në përputhje me Rregulloren (BE) nr. 1053/2013, shteti anëtar përkatës shqyrton, së bashku me Komisionin dhe Agjencinë Frontex, mënyrën e trajtimit të gjetjeve, duke përfshirë çdo mangësi dhe zbatimin e rekomandimeve brenda kuadrit të programit të tij kombëtar.

Sipas rastit, një shtet anëtar rishikon programin e tij kombëtar në përputhje me nenin 14, paragrafi 9 të Rregullores (BE) nr. 514/2014 për të marrë parasysh ato gjetje dhe rekomandime.

Financimi i masave korrigjuese është prioritet. Në dialogun me Komisionin dhe Agjencinë Frontex, shteti anëtar në fjalë rialokon burimet sipas programit të tij, përfshirë ato të programuara për mbështetje operative, dhe/ose paraqet apo ndryshon masat që synojnë të korrigjojnë mangësitë në përputhje me gjetjet dhe rekomandimet e raportit të vlerësimit të Shengenit.

Neni 13

Masat e BE-së

1. Me iniciativë të Komisionit, Instrumenti mund të përdoret për të financuar masat ndërkombëtare ose masat me interes të veçantë për BE-në ("masat e BE-së") në lidhje me objektivat e përgjithshëm, specifikë dhe operativë që përmenden në nenin 3.

2. Për të përfituar financim, masat e BE-së ndjekin në veçanti objektivat e mëposhtëm:

a) mbështetjen e masave përgatitore, monitoruese, administrative dhe teknike, të nevojshme për të zbatuar politikat e kufijve të jashtëm dhe të vizave, përfshirë forcimin e qeverisjes së zonës Shengen duke zhvilluar dhe zbatuar mekanizmin e vlerësimit sipas Rregullores (BE) nr. 1053/2013 për të verifikuar zbatimin e tërësisë së legjislacionit të Shengenit dhe Kodit për Kufijtë e Shengenit, në veçanti shpenzimet e misionit për ekspertët e Komisionit dhe shtetet anëtare që marrin pjesë në vizita në terren;

b) përmirësimin e njohurive dhe ideve mbi situatën që mbizotëron në shtetet anëtare dhe vende të treta përmes analizës, vlerësimit dhe monitorimit të afërt të politikave;

c) mbështetjen e zhvillimit të mjeteve statistikore, duke përfshirë mjetet e përbashkëta statistikore, metodat dhe treguesit e përbashkët;

d) mbështetjen dhe monitorimin e zbatimit të legjislacionit të BE-së dhe objektivave të politikave të BE-së në shtetet anëtare dhe vlerësimin e efektivitetit dhe ndikimit të tyre, përfshirë në lidhje me respektimin e të drejtave dhe lirive themelore njerëzore, sa i përket fushës së zbatimit të Instrumentit;

e) nxitjen e rrjetëzimit, shkëmbimit të përvojave, identifikimit dhe shpërndarjes së praktikave më të mira dhe qasjeve novatore midis aktorëve të ndryshëm në nivel evropian;

f) nxitjen e projekteve që synojnë harmonizimin dhe ndërveprimin e masave të lidhura me menaxhimin e kufijve në përputhje me standardet e përbashkëta të BE-së me qëllim zhvillimin e një sistemi të integruar Evropian për menaxhimin e kufijve;

g) nxitjen e ndërgjegjësimit për politikat e BE-së midis aktorëve dhe publikut të gjerë, përfshirë komunikimin institucional mbi prioritetet politike të BE-së;

h) rritjen e kapaciteteve të rrjeteve evropiane për të vlerësuar, promovuar, mbështetur dhe zhvilluar më tej politikat dhe objektivat e BE-së;

I. mbështetjen e projekteve veçanërisht novatore që zhvillojnë metoda dhe/ose teknologji të reja me potencial për transferueshmëri në shtetet e tjera anëtare, veçanërisht projekteve që synojnë të testojnë dhe të konfirmojnë projektet kërkimore;

j) mbështetjen e masave në lidhje me dhe në vendet e treta siç referohen në nenin 4, paragrafi 2.

3. Masat e BE-së miratohen në përputhje me nenin 6 të Rregullores (BE) nr. 514/2014.

Ndihma emergjente

1. Instrumenti siguron ndihmë financiare për të adresuar nevojat urgjente dhe specifike në rast të situatës emergjente siç përcaktohet në germën "f" të nenit 2.

2. Ndihma emergjente miratohet në përputhje me nenet 6 dhe 7 të Rregullores (BE) nr. 514/2014.

Neni 15

Krijimi i një programi për zhvillimin e sistemeve të IT-së

Programi për zhvillimin e sistemeve të IT-së, bazuar në sistemet ekzistuese dhe/ose të reja të IT-së, zbatohet me miratimin e akteve legjislative të BE-së që përcaktojnë ato sisteme të IT-së dhe infrastrukturën e tyre të komunikimit me qëllim përmirësimin e menaxhimit dhe kontrollin e flukseve të udhëtimit në kufijtë e jashtëm duke përforcuar kontrollet ndërsa përshpejton kalimet kufitare për udhëtarët e rregullt. Sipas rastit, kërkohen sinergji me sistemet ekzistuese të IT-së për të shmangur shpenzimet e dyfishta.

Ndarja e shumës së referuar në germën "b" të nenit 5, paragrafi 5 kryhet ose në aktet përkatëse legjislative të BE-së ose, pas miratimit të këtyre akteve legjislative, nëpërmjet një akti të deleguar në përputhje me nenin 17.

Komisioni informon Parlamentin Evropian dhe Këshillin për progresin në zhvillimin e atyre sistemeve të IT-së të paktën një herë në vit dhe në rastet e përshtatshme.

Neni 16

Asistenca teknike

1. Me nismën dhe/ose në emër të Komisionit, Instrumenti mund të kontribuojë deri në 1,7 milion euro në vit për asistencë teknike për Fondin në përputhje me nenin 9 të Rregullores (BE) nr. 514/2014.

2. Me nismën e një shteti anëtar, Instrumenti mund të financojë masa për asistencë teknike, në përputhje me nenin 20 të Rregullores (BE) nr. 514/2014. Shuma e lënë mënjanë për asistencë teknike nuk e kalon, për periudhën 2014–2020, 5 % të shumës totale që i alokohet një shteti anëtar plus 500 000 euro.

KREU III

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 17

Ushtrimi i delegimit

1. Kompetencat për të miratuar aktet e deleguara i delegohen Komisionit sipas kushteve të përcaktuara në këtë nen.

2. Kompetencat për të miratuar aktet e deleguara të përmendura në germën "b" të nenit 5, paragrafi 5 dhe nenet 6, paragrafi 4, 7 paragrafi 2 dhe nenit 15, i delegohen Komisionit për një periudhë shtatë vjeçare nga data 21 maj 2014. Komisioni harton një raport në lidhje me delegimin e kompetencave jo më vonë se nëntë muaj përpara përfundimit të periudhës shtatëvjeçare. Delegimi i kompetencave shtyhet në heshtje për periudha me kohëzgjatje të njëjtë nëse Parlamenti Evropian ose Këshilli nuk e kundërshton këtë shtyrje jo më vonë se tre muaj përpara përfundimit të periudhës shtatë vjeçare.

3. Delegimi i kompetencave që përmenden në germën "b" të nenit 5, paragrafi 5 dhe në nenet 6, paragrafi 4, 7 paragrafi 2 dhe 15 mund të revokohet në çdo kohë nga Parlamenti Evropian ose nga Këshilli. Vendimi i revokimit i jep fund delegimit të kompetencave të specifikuara në atë vendim. Ai hyn në fuqi një ditë pas botimit të vendimit në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian ose në një datë të mëvonshme që specifikohet në vendim. Ai nuk cenon vlefshmërinë e ndonjë akti të deleguar të hyrë tashmë në fuqi.

4. Kur miraton një akt të deleguar, Komisioni njofton për këtë njëkohësisht Parlamentin Evropian dhe Këshillin.

5. Një akt i deleguar i miratuar sipas germës "b" të nenit 5, paragrafi 5 dhe nenet 6, paragrafi 4, 7 paragrafi 2 dhe nenit 15, hyn në fuqi vetëm kur as Parlamenti Evropian dhe as Këshilli nuk ka shprehur asnjë kundërshtim brenda një periudhe dy mujore pas njoftimit të tyre për këtë akt, ose nëse, përpara përfundimit të kësaj periudhe, Parlamenti Evropian dhe Këshilli kanë informuar Komisionin se nuk do të kundërshtojnë. Kjo periudhë shtyhet me dy muaj me nismën e Parlamentit Evropian ose të Këshillit.

Neni 18

Procedura e Komitetit

1. Komisioni asistohet nga "Komiteti i Fondeve për Azilin, Migracionin dhe Integrimin e Sigurinë e Brendshme" i themeluar sipas nenit 59, paragrafi 1 të Rregullores BE nr. 514/2014.

2. Aty ku përmendet ky paragraf, gjen zbatim neni 5 i rregullores (BE) nr. 182/2011.

Neni 19

Zbatueshmëria e Rregullores (BE) nr. 514/2014

Dispozitat e Rregullores (BE) nr. 514/2014 zbatohen për Instrumentin.

Neni 20

Shfuqizimi

Vendimi nr. 574/2007/KE shfuqizohet më 1 janar 2014.

Neni 21

Dispozita kalimtare

1. Kjo rregullore nuk ndikon në vazhdimin apo modifikimin, përfshirë anulimin e plotë ose të pjesshëm, të projekteve dhe programeve vjetore deri në mbylljen e tyre, ose të ndihmës financiare të miratuar nga Komisioni në bazë të Vendimit nr. 574/2007/KE ose çdo legjislacioni tjetër që zbatohet për këtë ndihmë më datë 31 dhjetor 2013.

2. Gjatë miratimit të vendimeve për bashkëfinancimin në kuadër të Instrumentit, Komisioni merr parasysh masat e miratuara në bazë të Vendimit nr. 574/2007/KE përpara 20 Majit 2014, të cilat kanë pasoja financiare gjatë periudhës së mbuluar nga ai bashkëfinancim.

3. Shumat e zotuar për bashkëfinancim të miratuara nga Komisioni ndërmjet 1 janarit 2011 dhe 31 dhjetorit 2014 për të cilat dokumentet e kërkuara për mbylljen e veprimeve nuk janë dërguar në Komision deri në afatin e fundit për dorëzimin e raportit përfundimtar, anulohen automatikisht nga Komisioni deri më 31 dhjetor 2017, duke i hapur rrugën rimbursimit të shumave të paguara në mënyrë të padrejtë.

4. Shumat që lidhen me veprimet që janë pezulluar për shkak të procedimeve ligjore ose apelimeve administrative që kanë efekt pezullues, nuk merren parasysh në llogaritjen e shumës që do të likuidohet automatikisht.

5. Shtetet anëtare i dorëzojnë Komisionit deri më 30 qershor 2015 raportin e vlerësimit për rezultatet dhe ndikimin e veprimeve të bashkëfinancuara në zbatim të Vendimit nr. 574/2007/KE në lidhje me periudhën 2011-2013.

6. Përpara 31 dhjetorit 2015, Komisioni i dorëzon Parlamentit Evropian, Këshillit, Komitetit Evropian Ekonomik dhe Social dhe Komitetit të Rajoneve raportin e mëpasshëm të vlerësimit sipas Vendimit nr. 574/2007/KE për periudhën 2011-2013.

Neni 22

Rishikimi

Mbi bazën e një propozimi nga Komisioni, Parlamenti Evropian dhe Këshilli rishikojnë këtë rregullore deri më 30 qershor 2020.

Neni 23

Hyrja në fuqi dhe zbatimi

Kjo rregullore hyn në fuqi një ditë pas botimit të saj në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian.

Zbatimi i saj fillon nga data 1 janar 2014.

Kjo rregullore është detyruese në tërësinë e saj dhe drejtpërdrejt e zbatueshme në të gjitha shtetet anëtare, në përputhje me traktatet.

Nënshkruar në Strasburg, më 16 prill 2014.

Për Parlamentin Evropian

Presidenti

M. SCHULZ

Për Këshillin

Presidenti

D. KOURKOULAS

SHTOJCA I

SHUMAT QË PËRBËJNË BAZËN PËR PROGRAMET KOMBËTARE TË SHTETEVE ANËTARE (NË EURO)

Shteti anëtar/shteti i lidhur	Shuma minimale	Pjesë fikse e shpërndarë mbi bazat e mesatares 2010-2012	% 2010-2012 me Kroacinë	GJITHSEJ
AT	5 000 000	9 162 727	0,828 %	14 162 727
BE	5 000 000	12 519 321	1,131 %	17 519 321
BG	5 000 000	35 366 130	3,196 %	40 366 130
CH	5 000 000	13 920 284	1,258 %	18 920 284
CY	15 000 000	19 507 030	1,763 %	34 507 030
CZ	5 000 000	9 381 484	0,848 %	14 381 484
DE	5 000 000	46 753 437	4,225 %	51 753 437
DK	5 000 000	5 322 133	0,481 %	10 322 133
EE	5 000 000	16 781 752	1,516 %	21 781 752
ES	5 000 000	190 366 875	17,201 %	195 366 875
FI	5 000 000	31 934 528	2,886 %	36 934 528
FR	5 000 000	79 999 342	7,229 %	84 999 342

GR	5 000 000	161 814 388	14,621 %	166 814 388
HR	4 285 714	31 324 057	2,830 %	35 609 771
HU	5 000 000	35 829 197	3,237 %	40 829 197
IE				
IS	5 000 000	326 980	0,030 %	5 326 980
IT	5 000 000	151 306 897	13,672 %	156 306 897
LI	5 000 000	0	0,000 %	5 000 000
LT	5 000 000	19 704 873	1,780 %	24 704 873
LU	5 000 000	400 129	0,036 %	5 400 129
LV	5 000 000	10 521 704	0,951 %	15 521 704
MT	15 000 000	38 098 597	3,442 %	53 098 597
NL	5 000 000	25 609 543	2,314 %	30 609 543
NO	5 000 000	9 317 819	0,842 %	14 317 819
PL	5 000 000	44 113 133	3,986 %	49 113 133
PT	5 000 000	13 900 023	1,256 %	18 900 023
RO	5 000 000	56 151 568	5,074 %	61 151 568
SE	5 000 000	6 518 706	0,589 %	11 518 706
SI	5 000 000	25 669 103	2,319 %	30 669 103
SK	5 000 000	5 092 525	0,460 %	10 092 525
UK				
GJITHSEJ	169 285 714	1 106 714 286	100,00 %	1 276 000 000

SHTOJCA II

Lista e masave specifike

1. Vendosja e mekanizmave të bashkëpunimit konsullor midis të paktën dy shteteve anëtare që rezultojnë në ekonomi të shkallës për sa i përket procesit të aplikimeve dhe lëshimit të vizave në konsullata në përputhje me parimet për bashkëpunimin të përcaktuara në Kodin e Vizave, përfshirë qendrat e përbashkëta të aplikimit për vizë.

2. Blerja e mjeteve të transportit dhe pajisjeve operative që konsiderohen të nevojshme për dislokimin në operacionet e përbashkëta nga Agjencia Frontex dhe të cilat do të vihen në dispozicion të Agjencisë Frontex në përputhje me nënparagrafin e dytë dhe të tretë të nenit 7, paragrafi 5 i Rregullores (KE) nr. 2007/2004.

SHTOJCA III

OBJEKTIVAT PËR MBËSHTETJEN OPERATIVE BRENDIA PROGRAMEVE KOMBËTARE

Objektivi 1: promovimi i zhvillimit dhe zbatimit të politikave që sigurojnë mungesën e kontrolleve për personat, cilado qoftë shtetësia e tyre, kur kalojnë kufijtë e brendshëm dhe kryerjen e verifikimeve për personat dhe monitorimin efikas të kalimit të kufijve të jashtëm

- operacionet
- kostot e stafit, përfshirë ato për trajnim
- kostot e shërbimit, të tilla si mirëmbajtja dhe riparimi
- përmirësimi/zëvendësimi i pajisjeve
- pasuri të paluajtshme (amortizimi, restaurimi)

Objektivi 2: promovimi i zhvillimit dhe zbatimit të politikave të përbashkëta të vizave dhe lejeve të tjera të qëndrimit afatshkurtër, përfshirë bashkëpunimin konsullor

- kostot operative të stafit, përfshirë ato për trajnim
- kostot e shërbimit, mirëmbajtja dhe riparimi
- përmirësimi/zëvendësimi i pajisjeve
- pasuri të paluajtshme (amortizimi, restaurimi)

Objektivi 3: ngritja dhe menaxhimi i sistemeve të sigurta të IT-së, infrastrukturës së tyre të komunikimit dhe pajisjet që mbështesin menaxhimin e flukseve të migracionit, përfshirë mbikëqyrjen, në të gjithë kufijtë e jashtëm të BE-së

- menaxhimi operativ i SIS-it, VIS-it dhe sistemeve të reja që do të ngrihen

- kostot e stafit, përfshirë ato për trajnim
- kostot e shërbimit, të tilla si mirëmbajtja dhe riparimi
- infrastruktura dhe siguria e komunikimit si dhe çështje të lidhura me mbrojtjen e të dhënave
- përmirësimi/zëvendësimi i pajisjeve
- marrja me qira e ambienteve të sigurta dhe/ose restaurimi

SHTOJCA IV

LISTA E TREGUESVE TË PËRBASHKËT PËR MATJEN E OBJEKTIVAVE SPECIFIKE

a) Mbështetja e një politike të përbashkët të vizave për të lehtësuar udhëtimin e ligjshëm dhe për të gjurmuar emigracionin e paligjshëm

I. Numri i masave të bashkëpunimit konsullor të zhvilluara me ndihmën e Instrumentit

Për qëllimet e raporteve vjetore të zbatimit, siç përmenden në nenin 54 të Rregullores (BE) nr. 514/2014, ky tregues ndahet në nënkategori të tilla si:

- kolokacionet,
- qendrat e përbashkëta të aplikimit,
- përfaqësimet,
- të tjera.

II. Numri i stafit të trajnuar dhe numri i kurseve të trajnimit në aspektet e lidhura me politikën e përbashkët të vizave me ndihmën e Instrumentit

III. Numri i pikave të specializuara në vendet e treta që mbështeten nga instrumenti

Për qëllimet e raporteve vjetore të zbatimit, siç përmenden në nenin 54 të Rregullores (BE) nr. 514/2014, ky tregues ndahet në nënkategori të tilla si:

- oficerët ndërlidhës për emigracionin,
- të tjera.

IV. Përqindja dhe numri i konsullatave të ngritura apo të përmirësuara me ndihmën e Instrumentit nga numri total i konsullatave

b) Mbështetja e menaxhimit të kufijve, përfshirë përmes shkëmbimit të informacionit midis shteteve anëtare dhe ndërmjet shteteve anëtare e Agjencisë Frontex, për të siguruar, në një

anë, një nivel të lartë mbrojtjeje të kufijve të jashtëm, përfshirë me anë të gjurmimit të emigracionit të jashtëligjshëm dhe, nga ana tjetër, kalimin pa probleme të kufijve të jashtëm në përputhje me tërësinë e legjislacionit të Shengenit

I. Numri i stafit të trajnuar dhe numri i kurseve të trajnimit për aspekte që lidhen me menaxhimin e kufijve me ndihmën e Instrumentit

II. Numri i infrastrukturës së kontrolleve kufitare (kontrolle dhe mbikëqyrje) dhe mjeteve të zhvilluara ose të përmirësuara me ndihmën e Instrumentit

Për qëllimet e raporteve vjetore të zbatimit, siç përmenden në nenin 54 të Rregullores (BE) nr. 514/2014, ky tregues ndahet në nënkategori të tilla si:

- infrastruktura,
- flota (kufij ajrorë, tokësorë, detarë),
- pajisje,
- të tjera.

III. Numri i kalimeve të kufijve të jashtëm nëpërmjet portave ABC që mbështeten nga Instrumenti, nga numri total i kalimeve kufitare

IV. Numri i elementeve infrastrukturorë për mbikëqyrjen e kufijve kombëtarë të vendosura/ të zhvilluara më tej në kuadër të Eurosur-it

Për qëllimet e raporteve vjetore të zbatimit, siç përmenden në nenin 54 të Rregullores (BE) nr. 514/2014, ky tregues ndahet në nënkategori të tilla si:

- Qendrat Kombëtare të Koordinimit,
- Qendrat Rajonale të Koordinimit,
- Qendrat Lokale të Koordinimit,
- lloje të tjera qendrash koordinimi.

v) Numri i incidenteve të raportuara nga shtetet anëtare për Panoramën e Situatës Evropiane

Për qëllimet e raporteve vjetore të zbatimit, siç përmenden në nenin 54 të Rregullores (BE) nr. 514/2014, ky tregues ndahet në nënkategori të tilla si:

- emigracioni i jashtëligjshëm, përfshirë incidentet e lidhura me një rrezik për jetët e emigrantëve,
- krimi ndërkufitar,

1. *Gazeta Zyrtare C 299, 4.10.2012, f. 108.*
2. *Gazeta Zyrtare C 277, 13.9.2012, f. 23.*
3. Qëndrimi i Parlamentit Evropian i 13 marsit 2014 (ende i pabotuar në Gazetën Zyrtare) dhe Vendimi i Këshillit i 14 prillit 2014.
4. Rregullorja (BE) nr. 513/2014 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 16 prillit 2014 që vendosi, si pjesë e Fondit të Sigurisë së Brendshme, instrumentin për mbështetjen financiare për bashkëpunimin policor, parandalimin dhe luftën ndaj krimit dhe menaxhimin e krizës që shfuqizon Vendimin e Këshillit 2007/125/ÇBD (shihni faqen 93 të kësaj Gazete Zyrtare).
5. Rregullorja (BE) nr. 514/2014 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 16 prillit 2014 "Për vendosjen e dispozitave të përgjithshme mbi fondin e azilit, migracionit dhe integritit dhe mbi instrumentin për mbështetjen financiare për bashkëpunimin policor, parandalimin dhe luftën ndaj krimit dhe menaxhimin e krizës" (shihni faqen 112 të kësaj Gazete Zyrtare).
6. Vendimi nr. 574/2007/KE i Parlamentit Evropian dhe i Këshillit i 23 majit 2007 "Për krijimin e Fondit të Kufijve të Jashtëm për periudhën 2007 deri në 2013 si pjesë e programit të përgjithshëm Solidariteti dhe menaxhimi i flukseve të emigracionit" (*Gazeta Zyrtare L 144, 6.6.2007, f. 22*).
7. Rregullorja e Këshillit (KE) nr. 2007/2004, datë 26 tetor 2004, "Për ngritjen e Agjencisë Evropiane për Menaxhimin e Bashkëpunimit Operacional në Kufijtë e Jashtëm të Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian" (*Gazeta Zyrtare L 349, 25.11.2004, f. 1*).
8. Rregullore (BE) nr. 1168/2011 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e 25 tetorit 2011 që ndryshon Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 2007/2004 "Për ngritjen e Agjencisë Evropiane për Menaxhimin e Bashkëpunimit Operacional në Kufijtë e Jashtëm të Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian" (*Gazeta Zyrtare L 304, 22.11.2011, f. 1*).
9. Rregullorja e Këshillit (KE) nr. 693/2003 e 14 prillit 2003 "Për krijimin e një Dokumenti për Lehtësimin e Transitit (DLT), një Dokument për Lehtësimin e Transitit Hekurudhor (DLTH) dhe që ndryshon Udhëzimet e Përbashkëta Konsullore dhe Manualin e Përbashkët" (*Gazeta Zyrtare L 99, 17.4.2003, f. 8*).
10. Rregullorja e Këshillit (KE) nr. 694/2003 e 14 prillit 2003 "Për një format uniform të Dokumenteve për Lehtësimin e Transitit (DLT), dhe Dokumentet për Lehtësimin e Transitit Hekurudhor (DLTH)" që parashikohen në Rregulloren (KE) nr. 693/2003 (*Gazeta Zyrtare L 99, 17.4.2003, f. 15*).
11. Rregullorja (BE) nr. 1052/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 22 tetorit 2013 "Për themelimin e Sistemit Evropian për Mbikëqyrjen e Kufijve (Eurosur)" (*Gazeta Zyrtare L 295, 6.11.2013 f. 11*).
12. Rregullorja e Këshillit (BE) nr. 1053/2013, e 7 tetorit 2013, "Për vendosjen e një mekanizmi vlerësimi dhe monitorimi për të verifikuar zbatimin e tërësisë së legjislacionit të Shengenit dhe për shfuqizimin e Vendimit të Komitetit Ekzekutiv, të 16 shtatorit 1998, "Për vlerësimin dhe zbatimin e Shengenit" (*Gazeta Zyrtare L 295, 6.11.2013, f. 27*).
13. Rregullorja (BE) nr. 182/2011 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e 16 shkurtit 2011, "Për përcaktimin e rregullave dhe parimeve të përgjithshme për mekanizmat e kontrollit nga shtetet anëtare për ushtrimin e kompetencave zbatuese nga Komisioni" (*Gazeta Zyrtare L 55, 28.2.2011, f. 13*).
14. *Gazeta Zyrtare L 176, 10.7.1999, f. 36.*
15. Vendimi i Këshillit 1999/437/KE i 17 majit 1999 "Për masa të caktuara për zbatimin e marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet Këshillit të Bashkimit Evropian dhe Republikës së Islandës dhe Mbretërisë së Norvegjisë në lidhje me asociimin e këtyre dy shteteve në implementimin, zbatimin dhe zhvillimin e Shengenit" (*Gazeta Zyrtare L 176, 10.7.1999, f. 31*).
16. *Gazeta Zyrtare L 53, 27.2.2008, f. 52.*
17. Vendimi i Këshillit 2008/146/KE i 28 janarit 2008 "Për nënshkrimin në emër të Komunitetit Evropian, të marrëveshjes ndërmjet Bashkimit Evropian, Komunitetit Evropian dhe Konfederatës Zvicerane në lidhje me asociimin e Konfederatës Zvicerane në implementimin, zbatimin dhe zhvillimin e tërësisë së legjislacionit të Shengenit" (*Gazeta Zyrtare L 53, 27.2.2008, f. 1*).
18. *Gazeta Zyrtare L 160, 18.6.2011, f. 21.*
19. Vendimi i Këshillit 2011/350/BE, i 7 marsit 2011, "Për nënshkrimin, në emër të Bashkimit Evropian, të Protokollit ndërmjet Bashkimit Evropian, Komunitetit Evropian, Konfederatës Zvicerane dhe Principatës së Lihtenshtejnit për aderimin e Principatës së Lihtenshtejnit në marrëveshjen ndërmjet Bashkimit Evropian, Komunitetit Evropian dhe Konfederatës Zvicerane për asociimin e kësaj të fundit në implementimin, zbatimin dhe zhvillimin e tërësisë së legjislacionit, të Shengenit, në lidhje me heqjen e kontrolleve në kufijtë e brendshëm dhe lëvizjen e personave" (*Gazeta Zyrtare L 160, 18.6.2011, f. 19*).

20. Vendimi i Këshillit 2000/365/KE, i 29 majit 2000, "Për kërkesën e Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut për të marrë pjesë në disa nga dispozitat e tërësisë së legjislacionit të Shengenit" (*Gazeta Zyrtare L 131, 1.6.2000, f. 43*).
 21. Vendimi i Këshillit 2002/192/KE, i 28 shkurtit 2002, "Për kërkesën e Irlandës për të marrë pjesë në disa nga dispozitat e tërësisë së legjislacionit të Shengenit" (*Gazeta Zyrtare L 64, 7.3.2002, f. 20*).
 22. Rregullorja e Këshillit (BE, Euratom) nr. 1311/2013, e 2 dhjetorit 2013, "Për përcaktimin e kuadrit financiar shumëvjeçar për periudhën 2014-2020" (*Gazeta Zyrtare L 347, 20.12.2013, f. 884*).
 23. Rregullorja (KE) nr. 562/2006 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 15 mars 2006, "Për vendosjen e një Kodi të Komunitetit për rregullat që rregullojnë lëvizjen e personave ndërmjet kufijve (Kodi për Kufijtë e Shengenit)" (*Gazeta Zyrtare L 105, 13.4.2006, f. 1*).
 24. Rregullorja (KE) nr. 810/2009 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e 13 korrikut 2009, "Për vendosjen e një Kodi Komunitar për Vizat (Kodi i Vizave)" (*Gazeta Zyrtare L 243, 15.9.2009, f. 1*).
 25. Rregullorja (KE) nr. 767/2008 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e 9 korrikut 2008, "Për Sistemin e Informacionit të Vizave (VIS) dhe shkëmbimin e të dhënave ndërmjet shteteve anëtare për vizat afatshkurtra" (Rregullorja e VIS) (*Gazeta Zyrtare L 218, 13.8.2008, f. 60*).
 26. Rregullorja (KE) nr. 1931/2006 e Parlamentit evropian dhe e këshillit e 20 dhjetorit 2006 "Për rregullat mbi trafikun lokal kufitar në kufijtë e jashtëm tokësorë të shteteve anëtare dhe që ndryshon dispozitat e Konventës së Shengenit" (*Gazeta Zyrtare L 405, 30.12.2006, f. 1*).
 27. Rregullorja (BE, Euratom) nr. 966/2012 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 25 tetor 2012, "Për rregullat financiare të zbatueshme për buxhetin e përgjithshëm të Bashkimit Evropian dhe që shfuqizon Rregulloren e Këshillit (KE, Euratom) nr. 1605/2002" (*Gazeta Zyrtare L 298, 26.10.2012, f. 1*).
 28. *Gazeta Zyrtare C 373, 20.12.2013, f. 1*.
 29. Rregullorja e Këshillit (KE) nr. 866/2004 e 29 prillit 2004 "Për regjimin sipas nenit 2 të Protokollit nr. 10 të Aktit të Anëtarësimit" (*Gazeta Zyrtare L 161, 30.4.2004, f. 128*).
 30. *Gazeta Zyrtare L 129, 17.5.2007, f. 27*.
-